



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GYKATA E SHKALLËS SË PARË
TIRANË

NR. 1857 AKTI

NR. 180 VENDIMI

VENDIM

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e shkallës së parë Tiranë, e përbërë prej :

Gjyqtare: Altina Xhoxhaj

asistuar prej sekretares gjyqësore Ermira Çunge, sot më datë 19.01.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer te hapura, çështjen civile që i përket:

Kerkues : Anri Buzali i biri i Perit dhe Irfanes lindur më 07.06.1976 në Korçë, banues në Rr. "Ymer Kurti" pall.2, hyrja 3, ap.4, Tiranë.

Objekti : Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin Peri Buzali.

Baza ligjore: Neni 348 ,360 ,361 te Kodit Civil

Gjykata pasi shqyrtoi e bisedoi çështjen në tërësi, administroi provat shkresore, dëgjoi pretendimin e fundit të kerkuesit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës dhe lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore

V È R È N

Kerkuesi është i biri i të ndjerit Peri Buzali dhe si i tillë legjitimohet në paraqitjen e kërkesës për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për babain e tij.

Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi e provuar se:

sipas çertifikatës së vdekjes nr. 10-15 të Zyrës së Gjendjes Civile Njësia nr. 10 Tiranë, të lëshuar më datë 15.12.2004 rezulton që më datë 01.12.2004 ka vdekur trashëgimlënësi Peri Buzali.

Në kushtet kur trashëgimlënësi nuk ka lënë testament me të cilin të dispononte mbi pasurinë e tij të luajtshme dhe të paluajtshme, trashëgimtarë ligjore do të jenë ata të rradhës së parë: dhe konkretisht bashkëshortja Irfane Buzali dhe fëmijët Anri dhe Xheni Buzali. Siç figuron nga çertifikata e përbërjes familjare me nr. 10-15 lëshuar më datë 15.12.2004 nga Zyra e

V

Gjendjes Civile Njësia 10 Tiranë, trashëgimtarët janë gjallë, gjë që provohet nga çertifikatat e tyre të lindjes bashkëlidhur dosjes gjyqësore.

Duke qënë se gjatë gjykimit rezultoi që trashëgimlënësi nuk ka pasur fëmijë të tjerë të lindur jashtë martese apo të birësuar; se asnjëri prej trashëgimtarëve nuk është deklaruar i padenjë për të trashëguar apo që ata të kenë hequr dorë nga trashëgimia në favor të tyre, duhet të lëshohet dëshmia e trashëgimisë ligjore e trashëgimlënësit Peri Buzali, duke përcaktuar si trashëgimtarë të vëtëm të tij, trashëgimtarët ligjorë të rradhës së parë, që janë bashkëshortja dhe fëmijët e tij. Të sipërpermendurit do të trashëgojnë nga 1/3 pjesë secili gjithë pasurinë të luajtshme e të paluajtshme të trashëgimlënësit kudo që ajo të ndodhet; në po këtë masë dhe detyrimet që rrjedhin prej saj.

PËR KËTO ARSYE

Gjkata në bazë të nenit 306 e vijues të Kodit të Procedurës Civile

VENDOSI

Pranimin e kërkesës.

Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin Peri Buzali duke përcaktuar trashëgimtarët ligjorë të rradhës së parë:

1. Irfane Buzali (bashkëshortja)
2. Anri Buzali (i biri)
3. Xheni Buzali (e bija)

të cilët trashëgojne me nga 1/3 pjesë takuese secili gjithë pasurinë trashëgimore të luajtshme e të paluajtshme kudo që ndodhet. Në këtë masë dhe detyrimet që rrjedhin nga trashëgimia.

REPUBLICA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERËVE TIRIANE
NR 3427 REP. DT 01.04.05
VËRTETOHET

Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

VISI ME ORIGINALIN
NOTERE DRUTA PEPI

Kundër vendimit lejohet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së vendimit.

U shpall sot më datë 19/01/2005 në Tiranë.

SEKRETARE

ERMIRA CUNGE

VËRTETOHET SE KY VENDIM
MORI FORME TE PRERIME DIT
TIRANE 03.02.2005
04.02.2005 K/SEKRETARE
MIMOZA LULAJ

SHPENZIMET GJYQESORE PERISH
TAKSE PULLE: 100 LEKE

PULLE TAKSE 100 LEKE TIRANE SHKALLËS SË PARE

50 LEKE TIRANE SHKALLËS SË PARE

KANCELARI
ILIR SAULI